

PROCESVERBAL
nga seanca e 6-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe audiovizuele,
mbajtur më 15.2.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Llazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës Kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski,Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nuk ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, për shkak të shfrytëzimit të ditëve të pushimit.

Udhëheqësja e Sektorit për mbështetje të punës së Drejtorit dhe Këshillit - Shef Kabineti mr.Dragica Ljubevska, me autorizimin nr. 03-4905/1 të datës 28.12.2022, e zëvendësoi drejtorin e ASHMA-së.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë:
mr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska,Goran Radunoviq, mr.Emilija Petrevska Kamenjarova,Maja Damevska,mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 6-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:15 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 5-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 15.2.2023.
2. Propozim për sigurimin shtesë të mjeteve të nevojshme për zbatimin e kontratës për furnizim publik: Shërbime auditimi.
3. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë për arsye teknike, ka shtyrë (pezulluar) miratimin e Procesverbalit të propozuar të seancës së 5-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 15.2.2023 .

Pika 2

Udhëheqësja e Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit - Shef Kabineti mr.Dragica Ljubevska ka shpjeguar Propozimin për sigurimin shtesë të mjeteve (fondeve) të nevojshme për realizimin e kontratës për furnizim publik: Shërbime auditimi. Ajo shpjegoi se ka filluar procedura për furnizimin publik me vlerë të vogël, Shërbime auditimi për të cilën janë dorëzuar ofertat ndërsa komisioni për furnizime publike ka caktuar një ankand elektronik. Në ankand pjesë aktive ka marrë vetëm një operator, oferta e të cilit ka qenë 88.700 denarë më e lartë se shuma e paraparë në vendimin për furnizim publik. Komisioni i lëndës për furnizime publike ka përpiluar raport në të cilin ka sugjeruar që për realizimin e këtij furnizimi publik të sigurohen 88.700 denarë pa TVSH, sepse në bazë të inspektimit dhe analizës së procedurave të zhvilluara më herët për furnizim publik është konstatuar se mesatarja e çmimeve të ofruara për këtë shërbim në vitin 2020, 2021 dhe 2022 ishin në shumë prej 300.000,00 denarë e më shumë. Prandaj propozohet që Këshilli të japë miratim për sigurimin shtesë të mjeteve të nevojshme për zbatimin e kontratës për furnizim publik - Shërbime auditimi. Ajo theksoi se me këtë miratim do të ndryshohet dhe Vendimi për nevojën e furnizimit publik me shumë të shtuar, ndërsa mjetet sigurohen nga ribalanci i Planit Financiar, i cili është miratuar nga Këshilli në seancën e kaluar.

Z. Petrushevski tha se kishte dy arsye. Është e dukshme se është nënvlerësuar vlera e mëparshme sepse shërbimi ka bërë hulumtim pasi që mjetet duhet të jenë më të larta. Së dyti, është e dukshme që ka inflacion, rritje të të gjitha çmimeve dhe kjo reflektohet edhe në këtë shërbim. Kanë qenë tre kompani, nëse do të ishte një do të kishte dyshime, por këto ishin tre kompani që nuk kishin fitim për ta ulur çmimin. Ai tha se ky çmim që është marrë përmes ankandit ishte çmimi minimal që Agjencia mund ta merrte dhe e mbështet propozimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin për sigurimin shtesë të mjeteve të nevojshme për zbatimin e kontratës për furnizim publik - Shërbime auditimi për nevojat e Agjencisë, dhe rrjedhimisht për ndryshimin e Vendimit për nevojën e furnizimit publik, me tekst siç ishte propozuar.

Pika 3

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-747/3

23.02.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit**

Lazo PETRUSHEVSKI d.v